

VENDIM
Nr.108, datë 9.9.2008

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROCEDURAT E LICENCIMIT,
NDRYSHIMIT, TRANSFERIMIT TË PLOTË /TË PJESSHËM DHE RINOVIMIT TË
LICENCEVE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 14 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 21, të rregullores së procedurave të licencimit, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.9.2008, pasi u njoh me draftin final të rregullores për procedurat e licencimit përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores për procedurat e licencimit, ndryshimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licenceve (bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 4.4.2007 “Për miratimin e rregullores së procedurave të licencimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepavishta